

Kurti: Serbia mund të shfrytëzojë elemente destruktive për të nxitur incidente në Gazimestan FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

DEPUTETËT U PAJTUAN TA SHTYJNË SEANCËN KONSTITUIVE,
PAS AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE

A DO TË KONSTITUOHET KUVENDI TË DIELËN?

FAQE 4


Vazhdimi i 38 i seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës është ndërprerë të premtën pasi partitë politike janë pajtuar që ta vazhdojnë atë pas takimit të thirrur për të

shtunën nga kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti dhe pas aktgjyimit të Gjykatës Kushtetuese. Kryesuesi i seancës, Avni Dehari, ka thënë se seanca e radhës do të

mbahet më 29 qershor. Gjykata Kushtetuese vendosi se deputetët janë të detyruar ta përfundojnë seancën konstituive brenda 30 ditëve, më së largu deri më 26 korrik

AKTUALE



GJYKATA REFUZON TË SHTYJË GJYKIMIN KUNDËR NETANYAHUT F. 2

ÇEKU TAKON STRUKTURAT E LV-së NË PRISHTINË: FITORJA DO TË JETË E MADHE F. 6

NË KLINIKËN E NEUROLOGJISË AKTIVIZOHEN PAJISJET PËR TRAJTIMIN E PACIENTËVE ME EPILEPSI FARMAKOREZISTENTE F. 6

EKONOMI



QEVERIA NDAN 4 MILIONË EURO PËR POLICAT E SIGURIMIT TË MËRGIMTARËVE DHE MBI 625 MIJË EURO PËR ARSIMIN NË LUGINË F. 8

RRITEN TË ARDHURAT NGA TAKSAT MJEDISORE F. 8

SPORT



LLAPI FILLON PËRGATITJET ME 1 KORRIK, SYNON TË RIKTHEHET NË GARË PËR TROFE F. 10

ÇFARË RREZIKON KOSOVA NË MUNGESË TË INSTITUCIONEVE TË REJA? F. 5



BETOHEN 350 REKRUTË TË RINJ TË FSK-së F. 7



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË



Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Gjykata refuzon të shtyjë gjykimin kundër Netanyahu

JERUSALEM, 27 QERSHOR - Një gjykatë në Izrael refuzoi kërkesën e kryeministrit Benjamin Netanyahu, për të shtyrë dëshmimin e tij në gjyqin për korrupsion, pasi presidenti amerikan, Donald Trump, tha se ky rast gjyqësor duhet të anulohet.

Të enjten, avokati i Netanyahu i kërkoj gjykatës që të mos e thërriste kryeministrin për të dhënë dëshminë për dy javë, duke thënë se atij i duhet të përqendrohet në “çështje të sigurisë” pas luftës 12-ditore mes Izraelit dhe Iranit.

Gjykata e qarkut në Jerusalem tha në vendimin e publikuar online se “forma aktuale [e kërkesës së Netanyahu] nuk ofron bazë apo justifikim të

detajuar për anulimin e seancave dëgjimore”.

Trump tha të enjten se gjykimi kundër Netanyahu ishte një “gjueti shtrigash”, duke shtuar se gjykimi “duhet të anulohet menjëherë ose të falet ky hero i madh”.

Netanyahu e ka falënderuar Trumpin për mbështetjen e tij në luftën e shkurtër të Izraelit kundër Iranit, që përfundoi me një armëpushim të arritur më 24 qershor.

Kryeministri izraelit ka mohuar çdo keqbërje dhe mbështetësit e tij e kanë përshkruar gjykimin si të motivuar politikisht.

Në rastin e parë penal, ai dhe gruaja e tij, Sara, akuzohen se kanë pranuar më shumë se 260.000 euro në formë të



dhuratave luksoze sikurse cigare, bizhuteri dhe shampanja nga miliarderë në këmbim të favoreve politike.

Në dy raste të tjera, Netanyahu akuzohet se tentoi të negocionte mbulim më favorizues nga dy media izraelite.

Gjatë mandatit aktual, që e ka nisur në fund të vitit 2022, Qeveria e Netanyahu kishte propozuar një sërë reformash gjyqësore që kritikët thanë se ishin të dizajnuara që të dobësonin rolin e gjykatave.

Netanyahu ka kërkuar disa herë shtyrje që kur nisi gjykimi ndaj tij në maj të vitit 2020, duke përmendur si arsye luftën në Gazë që nisi më 2023 dhe më pas luftimet në Liban, si dhe gjatë këtij muaji konfliktin me Iranin.

SHBA-ja dhe Irani s'kanë caktuar bisedime bërthamore, por janë në kontakt

WASHINGTON, 27 QERSHOR - Shtetet e Bashkuara dhe Irani janë duke mbajtur kontakte të vazhdueshme për rifillimin e bisedimeve mbi programin bërthamor të Teheranit, por ende nuk kanë caktuar bisedime formale, thanë zyrtarë nga të dyja vendet të enjten vonë.

Uashingtoni është “në komunikim të afërt” me Iranin dhe ndërmjetësit e tij, tha zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë, Karoline Leavitt, në një konferencë për shtyp, ndërsa ministri i Jashtëm iranian, Abbas Araqchi, i tha transmetuesit shtetëror IRIB se diplomacia po vazhdon dhe kontaktet po zhvillohen përmes kanaleve të ndryshme.

Araqchi shtoi se nuk është bërë asnjë “marrëveshje, aranzhim apo bisedë për t'i nisur bisedimet e reja bërthamore”.

Ai theksoi se Irani tani po vlerëson se çfarë është më e mira për interesat kombëtare, duke shtuar se “thashethemet” se Teherani do të rikthehet në tryezën e bisedimeve “nuk duhet të merren seriozisht”.

Presidenti amerikan, Donald Trump, duke folur në samitin e NATO-s në Hagë më 25 qershor, tha se Uashingtoni do të zhvillojë bisedime me Teheranin javën e ardhshme.

Rundi i gjashtë i bisedimeve SHBA-Iran në Oman, i caktuar për 15 qershor, u anulua pasi forcat izraelite kryen sulme mbi caqet iraniane më 13 qershor.

Duke folur për IRIB, Araqchi konfirmoi se sulmet e fundjavës së kaluar nga forcat amerikane shkaktuan dëme “të konsiderueshme” në



infrastrukturën bërthamore të Iranit.

Komentet e Araqchi vijnë pak orë pasi mbikëqyrësi kushtetues i Iranit, Këshilli i Gardës, e miratoi vendimin e Parlamentit për të pezulluar bashkëpunimin e Teheranit me Agjencinë Ndërkombëtare për Energjinë Atomike (IAEA).

Për këtë ligj, i cili u miratua një ditë më parë nga ligjvënësit me 221 vota pro dhe asnjë kundër, do të vendosë përfundimisht Këshilli Suprem i Sigurisë Kombëtare (SNSC).

SNSC teknikisht drejtohet nga presidenti, por ashtu si të gjitha institucionet kyçe të shtetit, i përgjigjet udhëheqësit suprem, ajatollah Ali Khamenei. “Plani për ta detyruar Qeverinë ta pezullojë bashkëpunimin me Agjencinë Ndërkombëtare për

Energjinë Bërthamore nuk ishte në kundërshtim me ligjin islamik dhe Kushtetutën pas shqyrtimit nga anëtarët e Këshillit të Gardës”, tha zëdhënësi i këshillit, Hadi Tahan Nazif, në një postim në X.

Izraeli kreu sulme të papara ndaj objekteve kyçe bërthamore dhe ushtarake të Iranit, si dhe zonave të banuara, më 13 qershor, në një luftë që mori jetën e shumë civilëve nga të dyja palët para se të përfundonte me një armëpushim të brishtë të ndërmjetësuar nga Shtetet e Bashkuara më 24 qershor.

Pezullimi i bashkëpunimit me IAEA do të thotë se Irani do t'i ndalojë inspektimet, raportimet dhe veprimtarinë mbikëqyrëse sipas Traktatit për Mospërhapjen e Armëve

Bërthamore (NPT).

Para votimit, kryetari i Parlamentit, Mohammad Baqer Qalibaf, e kritikoi IAEA-n, duke thënë se ajo dështoi “qoftë edhe të shtirë sikur e dënonte sulmin ndaj objekteve bërthamore të Iranit” dhe e akuzoi për “shitjen e besueshmërisë së vet ndërkombëtare”.

Teherani ka akuzuar prej kohësh IAEA-n për anshmëri dhe bashkëpunim me fuqitë perëndimore dhe Izraelin kundër Iranit.

Projektligji parashikon që pezullimi i bashkëpunimit të hiqet vetëm nëse garantohet që objektet dhe shkencëtarët bërthamorë iranianë janë të mbrojtur dhe që e drejta e Iranit për të pasuruar uranium brenda vendit është e garantuar.

Drejtori i Përgjithshëm i IAEA-s,

Rafael Grossi, ka shprehur prej vitesh shqetësimin për mungesën e bashkëpunimit nga Irani në hetimet për objekte të vjetra, por të padeklaruara, bërthamore.

“Organizata për Energjinë Atomike e Iranit do të pezullojë bashkëpunimin me agjencinë deri sa të garantohej siguria e objekteve bërthamore, dhe programi bërthamor paqësor i Iranit do të ecë përpara me një ritëm më të shpejtë”, tha Qalibaf në komentet që u pasuan nga thirrjet e ligjvënësve “vdekje Amerikës dhe Izraelit”.

Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, tha se “skenari më i keq” do të ishte nëse Teherani tani do të largohej nga Traktati për Mospërhapjen e Armëve Bërthamore.

Macron u tha gazetarëve në Bruksel, pas një samiti të BE-së, se në përpjekje për të ruajtur traktatin, ai do të fliste në ditët në vijim me pesë anëtarët e Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Këto bisedime tashmë kanë filluar me një telefonatë në Shtëpinë e Bardhë më 26 qershor, në të cilën ai informoi presidentin Donald Trump për kontaktet që Parisi ka pasur me Teheranin “në ditët dhe orët e fundit”. “Shpresa jonë është që të ketë një konvergjencë të vërtetë të pikëpamjeve”, tha Macron, duke shtuar se synimi është “që të mos ketë rifillim” të ndërtimit bërthamor nga Irani. Irani e ratifikoi traktatin për mospërhapjen e armëve bërthamore (NPT) në vitin 1970, duke u angazhuar të deklarojë materialin e tij bërthamor para Agjencisë Ndërkombëtare për Energji Atomike.

ÇFARË RREZIKON KOSOVA NË MUNGESË TË INSTITUCIONEVE TË REJA?

A ka diçka më të parashikueshme momentalisht sesa seancat për konstituimin e Kuvendit të Kosovës? Asgjë nuk ndërron në ato 2-3 minuta seancë, përveç rrobave të deputetëve. Një thënie, që i atribuohet shpesh fizikanit Albert Einstein, thotë se “çmenduri është të bësh të njëjtën gjë vazhdimisht, dhe të presësh rezultate të ndryshme”. Çfarë, atëherë, duhet të ndryshojë në rastin e Kuvendit, që shteti të mos marrë tatëpjetën?

PRISHTINË, 27 QERSHOR - Kosova po e vuan edhe politikisht, edhe financiarisht, sagën për konstituimin e Kuvendit, pas zgjedhjeve të 9 shkurtit. Më 26 qershor, Gjykata Kushtetuese ka marrë vendim që seanca konstituive të përfundojë brenda 30 ditësh. Partitë kanë dalë menjëherë me interpretimet e tyre sa i përket votimit të fshehtë për kandidaten për kryeparlamentare. Do të kemi kohë të shohim se çfarë do të ndodhë... Tani të ndalemi te faktori financiar.

Në mungesë të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare me Bankën Botërore, Kosova është duke rrezikuar humbjen e 230 milionë eurove.

Një pjesë e marrëveshjeve, në vlerë të 130 milionë eurove, janë zvarritur prej vitit 2024, ndërsa tjerat, në vlerë të 100 milionë eurove, janë ujdë të reja.

E, për Kosovën, një ndër vendet më të varfra në Evropë, çdo euro është e vlefshme.

Blendi Hasaj, drejtor ekzekutiv në Institutin për Hulumtime të Avancuara GAP, thotë për Radion Evropa e Lirë (REL) se disa prej këtyre mjeteve i janë ndarë Kosovës në formë granti - pra pa kthim. “Këto marrëveshje kanë të bëjnë me përkrahjen në tranzicionin e gjelbër, në rritjen e konkurrueshmërisë, po ashtu për të bërë një riaktivizim të sistemit informativ shëndetësor, projekte që kanë të bëjnë me edukimin në fëmijëri të hershme”.

Marrëveshjet ndërkombëtare ratifikohen në Kosovë me dy të tretat e votave të deputetëve.

Një tjetër projektligj shumë i rëndësishëm ka të bëjë me mjetet që mund t'i përfitojë Kosova, përmes atij që njihet si Plani i Rritjes i Bashkimit Evropian (BE).



Nga fondi prej 6 miliardë eurosh për vendet e Ballkanit Perëndimor, Kosovës i kanë rënë hise rreth 900 milionë - një pjesë në formë granti, dhe një formë si kredi.

Nëse analizohet për kokë banori, Kosova është përfituesja më e madhe e këtyre mjeteve. Për dallim prej saj, disa vende fqinje tashmë i kanë pranuar 7 për qind të mjeteve si parafinancim, që do të thotë se Kosova do të mund t'i pranonte lehtësisht rreth 61 milionë euro.

Kur është afati i fundit për miratim?

Për të paktën 90 milionë euro të ndara nga Banka Botërore, me zero për qind kamatë, alarmin e ka ndezur ministri në detyrë i

Financave, Hekuran Murati.

Ai ka thënë që, nëse marrëveshja nuk ratifikohet deri në shtator, “ekziston rreziku shumë i lartë që këto mjete t'i merren Kosovës dhe t'i jepen një shteti tjetër”.

Edhe fondet tjera mund ta kenë këtë fat. Hasaj beson se presion ka edhe brenda vetë Bankës Botërore. “Menaxherët e Bankës Botërore duhet të kenë një presion që të nisë sa më shpejt zbatimin e tyre [projekteve]. Mos të harrojmë që disa prej këtyre kredive që po i ndahen Kosovës janë me norma tejet tërheqëse, dhe besoj që kërkesa për kredi të tilla është e madhe edhe nga shtetet tjera”.

Augustin Palokaj, gazetar që përcjell politikën e BE-së, thotë për REL-in se, ndonëse disa politikanë kanë deklaruar se ka kohë për pranimin e fondeve të

BE-së, ato në fakt janë para të afatizuara për periudhën 2024-2027. “Nëse vazhdon ky ngërç politik, nëse Kosova vazhdon të mos ketë qeveri deri në pranverën e vitit që vjen, me mundësi për t'i ratifikuar marrëveshjet ndërkombëtare, atëherë mund t'i afrohem afatit kur mund të humbë një pjesë shumë e madhe e këtyre parave”. Përveç kësaj, ai rikujton se Kosova vazhdon të jetë nën masë ndëshkuese të BE-së, dhe kështu nuk ka qasje në ndihmën financiare nga paratë e paraanëtarësimit (IPA). “Ka vende anëtare të BE-së, të cilat thonë se nuk do të kishte kuptim as heqja e masave, përderisa Kosova të mos ketë institucione me të cilat BE-ja do të punonte, pasi janë disa kushte që duhet plotësuar”.

Qeveri pa legjitimitet për të marrë vendime të rëndësishme

Kriza politike po reflektohet edhe në vonesa për integrimin e Kosovës në struktura ndërkombëtare, pasi Qeveria aktuale në detyrë nuk ka legjitimitet për të marrë vendime të rëndësishme strategjike në emër të Kosovës.

Sipas Palokajt, problemi politik është vërtetuar gjatë vizitës së kryediplomates së BE-së, Kaja Kallas, para disa javësh në Prishtinë. “Ajo është takuar me liderë të institucioneve të Kosovës, më shumë në cilësinë e përfaqësuesve të partive politike, pasi që janë të vetëdijshëm se në rrethanat ekzistuese nuk mund t'u jepet legjitimitet i plotë”.

Në këtë situatë, procesi i dialogut me Serbinë mund të mbetet në vendnumëro, ashtu sikurse synimi për anëtarësim në Këshillin e Evropës, pasi në mungesë të institucioneve kompetente, nuk ka vullnet që Gjykatës Kushtetuese t'i dorëzohet për shqyrtim drafti për formimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe - si kusht për anëtarësim. “Një qeveri e Kosovës, që atëherë [më 2024] ishte shumë stabile, nuk e ka bërë këtë, prandaj është e paimagjinueshme që këtë tash ta bëjë një qeveri në largim”, thotë Palokaj.

Ndërkohë, shoqëria civile e kundërshton bllokadën e krijuar nga partitë politike, dhe në njërin prej aksioneve të fundit, pjesëtarë të saj pyesnin me pankarta në duar: “Deri kur?”. Me sa duket, askush nuk e ka një përgjigje...

AIP bëhet anëtare e Komitetit drejtues të Rrjetit Evropian për Transparencë

PRISHTINË, 27 QERSHOR - Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP) është zgjedhur anëtare e Komitetit Drejtues të Rrjetit Evropian për Transparencë dhe Qasje në Informata (ENTRI), gjatë Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve për të Drejtën e Informimit (ICIC), e mbajtur më 24 qershor 2025 në Berlin.

Sipas njoftimit, Rrjeti ENTRI u krijua pas një takimi fillestar njoftues me pjesëmarrjen e të gjitha shteteve evropiane, ku

AIP, përmes Komisioneres Krenare Sogojeva-Dermaku, shprehu interesimin për t'u bërë pjesë aktive e këtij Rrjeti duke kandiduar për Komitetin Drejtues. Në sesionin e dytë të Konferencës, shtetet anëtare të ICIC, me votim unanim, përzgjedhën Kosovën, Portugalinë, Spanjën, Francën dhe Skocinë si anëtare të Komitetit Drejtues, ndërsa Gjermania u zgjodh Kryesuese e këtij Rrjeti. “Ky zhvillim shënon një arritje të

rëndësishme në avancimin e pozitës ndërkombëtare të Republikës së Kosovës në fushën e transparencës dhe të drejtës për qasje në dokumente publike”, thuhet në njoftimin për medie, duke shtuar se Rrjeti Evropian për Transparencë dhe Qasje në Informata (ENTRI) është themeluar si platformë bashkëpunimi ndërmjet institucioneve evropiane që mbrojnë dhe promovojnë të drejtën e qasjes në informata publike.





DEPUTETËT U PAJTUAN TA SHTYJNË SEANCËN KONSTITUIVE,
PAS AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE

A DO TË KONSTITUOHET KUVENDI TË DIELËN?

Vazhdimi i 38 i seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës është ndërprerë të premten pasi partitë politike janë pajtuar që ta vazhdojnë atë pas takimit të thirrur për të shtunën nga kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti dhe pas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese. Kryesuesi i seancës, Avni Dehari, ka thënë se seanca e radhës do të mbahet më 29 qershor. Gjykata Kushtetuese vendosi se deputetët janë të detyruar ta përfundojnë seancën konstituive brenda 30 ditëve, më së largu deri më 26 korrik.

shumë përpjekjeve të dështuara, kur Gjykata Kushtetuese shpalli vendim që i detyron ata ta bëjnë Kuvendin.

Gjykata Kushtetuese vendosi se deputetët janë të detyruar ta përfundojnë seancën konstituive brenda 30 ditëve, më së largu deri më 26 korrik.

Lideri i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se Gjykata Kushtetuese dha qartësi: zgjedhja e kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit duhet të ndodhë brenda 30 ditëve. "Siç kemi theksuar që në fillim, rendi i ditës i seancës konstituive nuk mund të ndryshohet sipas dëshirës dhe askush nuk ka të drejtë të imponojë votim të fshehtë pa bazë kushtetuese dhe pa procedurë të rregullt. Gjatë tërë kësaj kohe, Partia Demokratike e Kosovës ka vepruar me përgjegjësi, seriozitet dhe konstruktivitet. Kemi ofruar zgjidhje, jo bllokim. Kemi kërkuar respektimin e rendit demokratik, jo skema për ta shtyrë apo thelluar krizën institucionale. E kemi përkrahur me ekspertizë dhe jemi bashkuar me iniciativën e AAK-së për sqarim kushtetues, sepse besojmë fuqishëm se demokracia mbrohet përmes

ligjshmërisë dhe transparencës. Na vjen mirë që Gjykata Kushtetuese i dha fund kësaj loje të qëllimshme vonësash nga koalicioni VV-Guxo-Alternativa, duke e bërë të qartë se ata nuk kanë të drejtë ta bllokojnë procesin dhe se Kuvendi duhet të konstituohet brenda 30 ditëve. Ky aktgjykim duhet të zbatohet menjëherë. Sa më shpejt, aq më mirë për vendin", ka thënë Krasniqi.

Deputetja e zgjedhur e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Hykmete Bajrami, ka thënë se Lëvizja Vetëvendosje është e interesuar që të vazhdojë situatën e njëjtë, moskonstituimin e Kuvendit.

Bajrami ka theksuar se Kosova është në këtë ngërç politik "për shkak të kokëfortësisë dhe insistimit të Vetëvendosjes" në emrin e Albulena Haxhiut për kryetare të Kuvendit.

Bajrami ka shtuar se kryesuesi i seancës, Avni Dehari, është duke ua pamundësuar deputetëve të LDK-së, që të votojnë, ndërkohë që ka konfirmuar se Lidhja Demokratike e Kosovës, do të merr pjesë në takimin e thirrur nga kryetari i Vetëvendosjes, Albin Kurti, për të shtunën, me qëllim të arritjes së një

marrëveshje politike.

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se bashkëpunimi mes forcave politike është i domosdoshëm për të arritur deri te konstituimi i Kuvendit.

Haradinaj tha se, pas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, "janë pjekur kushtet për të kthyer votimin e hapur".

Haradinaj tha se do të kërkojnë një konsultë me kryesuesin e seancës, Avni Dehari.

Në këtë konsultë, Haradinaj tha se do të kërkohej mundësia e rikthimit të votimit të hapur dhe të mos procedohet me përpjekjen për votim të fshehtë.

Konjufca: Gjykata nuk gjeti shkelje në lidhje me votimin e fshehtë

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Glauk Konjufca, i ka hedhur poshtë interpretimet se Gjykata Kushtetuese gjeti se kryesuesi i seancës konstituive, Avni Dehari i Vetëvendosjes, e shkeli Kushtetutën duke propozuar votim të fshehtë për zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit.

Duke folur në një konferencë

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 27 QERSHOR - Të premten deputetët u mblodhën për herën e 38 për ta konstituuar Kuvendin e dalë nga zgjedhjet e 9 shkurtit.

Deputetët u pajtuan që ta shtyjnë takimin për të dielën, 29 qershor, në pritje të një takimi të liderit të LV-së, Albin Kurti, me krerët e partive të tjera parlamentare dhe pas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese.

Kurti i ftoi të gjithë krerët e partive parlamentare për një takim për të shtunën në orën 16:00. "Aktgjykimi i djeshëm i Gjykatës Kushtetuese thekson qartë se obligimi për ta

konstituuar Kuvendin është obligim i të gjithë deputetëve dhe jo vetëm i subjektit të parë. Si kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje! dhe në emër të grupit më të madh parlamentar të dalur nga zgjedhjet e 9 shkurtit 2025, sot u jam drejtuar të gjithë krerëve të subjekteve të përfaqësuara në legjislaturën e nëntë, me ftesë për takim të përbashkët të shtunën (nesër) në orën 16:00, në përpjekje të radhës në funksion të konsensusit për konstituim të Kuvendit", ka shkruar Kurti të premten në "Facebook". Krerët e partive më të mëdha parlamentare thanë se do të shkojnë në takim. Një momentum i ri u krijua të enjten në mbrëmje, pas shumë e

Çeku takon strukturat e LV-së në Prishtinë: Fitorja do të jetë e madhe

PRISHTINË, 27 QERSHOR - Kandidati i Lëvizjes për kryetar të Prishtinës në zgjedhjet e 12 tetorit, Hajrulla Çeku, të premtën së bashku me kryetarin e Qendrës, Arben

Vitia, dhe anëtarë të kryesisë, zhvilluan takim me strukturat e qendrës në Prishtinë. “Entuziazmi është i madh, ndërsa përgjegjësia ndaj Prishtinës është edhe më e

madhe. Vetëvendosje e do Prishtinën për qytetarët e do të jetueshme, të dinjitetshme. Prishtina meriton më shumë, sepse qytetarët e saj e duan me zemër dhe nuk pranojnë ta

lënë në këtë gjendje degradimi. Fitorja që po vjen do të jetë e madhe sepse do të jetë e të gjithëve. Është fitorja e Prishtinës”, ka njoftuar Lëvizja Vetëvendosje në Prishtinë.



NË KLINIKËN E NEUROLOGJISË AKTIVIZOHEN PAJISJET PËR TRAJTIMIN E PACIENTËVE ME EPILEPSI FARMAKOREZISTENTE



PRISHTINË, 27 QERSHOR - Në Klinikën e Neurologjisë të Qendrës Klinike Universitare (QKUK), është përmbyllur me sukses faza e dytë të trajtimit të pacientëve me epilepsi farmakorezistente përmes pajisjeve të stimulimit të nervit vagus (VNS).

Pas fazës së parë të implantimit të pajisjeve me 2 dhe 3 qershor 2025, me 20 qershor është realizuar aktivizimi i parë i këtyre pajisjeve, pasi u vlerësua se plagët operative janë shëruar

plotësisht. Aktivizimi është bërë në Klinikën e Neurologjisë nga ekipi i neurologëve të ShSKUK-së, me mbështetjen profesionale të specialistit nga Polonia, dr. Filip Tetzta, dhe në prani të prindërve të pacientëve.

Ky proces shënon një arritje të rëndësishme për ShSKUK-në, pasi për herë të parë është mundësuar ofrimi i këtij shërbimi brenda vendit për pacientët me epilepsi farmakorezistente, shërbim për

të cilin më parë është kërkuar trajtim jashtë vendit me kosto të lartë për familjarët dhe institucionet.

Tre pacientët e parë që janë trajtuar me këtë metodë nuk do të kenë më nevojë për udhëtojnë jashtë vendit, meqë mirëmbajtja dhe kalibrimi i pajisjeve do të bëhet në Klinikën e Neurologjisë.

Rastet do të jenë në monitorim dhe mbikëqyrje nga stafi mjekësor, sipas protokolleve mjekësore.

NGRIHET AKTAKUZË KUNDËR NJË PERSONI PËR KRIME LUFTE NË GJAKOVË

PRISHTINË, 27 QERSHOR - Prokuroria Speciale e Kosovës njoftoi të premtën se ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit D.R., për veprën penale “krim i luftës kundër popullsisë civile”. Hetimet zbuluan se gjatë periudhës 7-10 maj të vitit 1999, i pandehuri ka marrë pjesë në sulm të gjerë dhe të organizuar të forcave ushtarake, policore dhe paramilitare serbe kundër popullsisë civile shqiptare në Gjakovë, thuhet në njoftim. Aty bëhet e ditur se ai ka vepruar në bashkëkryerje me persona të tjerë. “Aktakuza e ngarkon të

pandehurin me përgjegjësi për vrasjen e tre civilëve shqiptarë, të cilët më pas janë keqtrajtuar fizikisht, si dhe për dëbimin e dhunshëm të civilëve nga shtëpitë e tyre, plaçkitjen dhe shkatërrimin e pronave në disa lagje të qytetit”, bëri të ditur prokuroria.

Provat kundër të pandehurit përfshijnë dëshmi të viktimave dhe dëshmitarëve okularë, identifikimin e tij përmes fotografive, raporte të Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe materiale të tjera të mbledhura gjatë hetimeve. I pandehuri

ndodhet në paraburgim, ndërsa prokuroria tha se ka kërkuar vazhdimin e kësaj mase, për shkak të rrezikut të arratisjes. Gjatë luftës në Kosovë më 1998/99 u vranë mbi 13.000 civilë, ndërsa mijëra të tjerë u zhdukën.

Rreth 1.600 persona, kryesisht shqiptarë, janë ende në kërkim. Ndër vite, autoritetet e drejtësisë në Kosovë kanë akuzuar ose dënuar disa persona për krime lufte.

Dhjetë ditë më parë, një person u dënua me 15 vjet burgim për dhunë seksuale gjatë luftës.



RRETH 24 MIJË NXËNËS I NËNSHTROHEN TESTIT TË ARRITSHMËRISË



PRISHTINË, 27 QERSHOR - Rreth 24 mijë nxënës të klasave të nënta, në të gjithë Kosovën, të premtën i janë nënshtruar testit të arritshmërisë, një nga vlerësimet më të rëndësishme në përfundim të arsimit të obligueshëm. Testimi u zhvillua në 170

qendra të testimit, me angazhimin e mbi 1,500 administruesve. Nxënësit u testuan në nëntë lëndë: Gjuhë Shqipe, Gjuhë Angleze, Histori, Gjeografi, Matematikë, Informatikë, Fizikë, Kimi dhe Biologji. Ky test shërben si bazë për orientimin

e mëtejshëm arsimor të nxënësve në shkollat e mesme. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) ka paralajmëruar masa të rrepta kundër kopjimit gjatë testimit. Në rast konstatimi se janë përdorur telefona ose është bërë

shpërndarja e materialeve të paautorizuara, sipas MASHTI-t, nxënësit do të largohen nga testi.

Sipas Ministrisë së Arsimit, rezultatet e testit të arritshmërisë për nxënësit e klasave të nënta, pritet të shpallen deri më 5 korrik.

Faton Peci, kandidat i LV-së për kryetar të Mitrovicës

PRISHTINË, 27 QERSHOR - Ministri në detyrë i Bujqësisë, deputeti, Faton Peci, do të jetë kandidat për kryetar të Mitrovicës në zgjedhjet lokale të 12 tetorit. Kryetari i LV-së, Albin Kurti, ka thënë se Fatoni e do shumë

Mitrovicën e tij, e ai i duhet Mitrovicës sonë. “Të gjithë e njohin si ministri më i suksesshëm i Bujqësisë. Bashkëpunëtor shembullor në koalicionin tonë qeverisës, ministër i jashtëzakonshëm në

qeverisje, Faton Peci, bashkëkryetari i Partisë Guxo është i nominuar për kandidat për kryetar të Komunës së Mitrovicës së jugut në zgjedhjet e 12 tetorit dhe e ka mbështetjen tonë të plotë.

Fatoni e do shumë Mitrovicën e tij, e ai i duhet Mitrovicës sonë. Sot është ministër në detyrë. Në vjeshtë, Faton Peci do të jetë kryetar në krye të detyrës”, ka thënë Kurti për nominimin e tij për kryetar të Mitrovicës.



KURTI: SERBIA MUND TË SHFRYTËZOJË ELEMENTE DESTRUKTIVE PËR TË NXITUR INCIDENTE NË GAZIMESTAN

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 27 QERSHOR - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, në mbledhjen e qeverisë të premten ka thënë se këtë javë në Hagë të Holandës u mbajt Samiti i 34-të i NATO-s, duke përshëndetur përfundimin e punimeve të këtij samiti si dhe vendimin unanim të vendeve anëtare të NATO-s për rritjen e shpenzimeve të mbrojtjes në 5% të Bruto Prodhimit Vendor. “E vlerësojmë lart edhe rikonfirmimin e vendeve anëtare për zotimin për mbrojtje kolektive që adresohet në Nenin 5 si një ndër parimet themelore të NATO-s. Gjithashtu, përshëndesim vendimin për mbajtjen e Samitit të 36-të të NATO-s në Tiranë, në Republikën e Shqipërisë, në vitin 2027”, ka thënë ai.

Kurti ka thënë se Republika e Kosovës është e palëkundur në rrugëtimin e saj drejt anëtarësimit në NATO. “Qeveria e Republikës së Kosovës ka rritur dhe po vazhdon të rrisë investimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë me qëllim mbrojtjen e sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Republikës, si dhe kontributin për sigurinë evropiane dhe më gjerë. E pikërisht sot Forcës së Sigurisë së Kosovës ia shtuam edhe 350 rekrutë të rinj, gjithsej 2700 pjesëtarë më shumë për



ushtrinë tonë në këtë mandat”, ka pohuar ai.

Kurti ka thënë se siç e dini, në fundjavë shënohet Dita e Shën Vidit, apo Vidovdan siç njihet, e cila ndonëse ditë me karakter fetar, fatkeqësisht në vazhdimësi është përcjellë me retorikë politike nxitëse e kërcënuese për sigurinë

publike nga ana e Serbisë. “Beogradi zyrtar, që po përballlet me protesta të vazhdueshme e gjithandej të studentëve dhe jo vetëm, po përpiket që ta zhvendosë vëmendjen diku tjetër. Në këtë përpjekje për të ulur përmasat e protestës anti-qeveritare e anti-regjim të të njëjtës ditë në

Beograd, pushteti në Serbi mund të shfrytëzojë elemente destruktive për të nxitur incidente në Gazimestan. Sipas vlerësimeve të institucioneve tona të sigurisë dhe inteligjencës, ka përpjekje që tubimi në Gazimestan të jetë sa më masiv. Prandaj janë organizuar grupe serbësh nga

Serbia, Mali i Zi dhe Bosnja e Hercegovina që të vijnë në Kosovë nesër. Tradicionalisht, grupet e tilla kanë qenë provokuese, duke bartur simbole nacionaliste serbe e ruse, që bien në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës dhe janë gjithashtu edhe kundër vlerave demokratike e evropiane”, ka thënë Kurti.

Ai u ka bërë thirrje të gjithë bashkëqytetarëve tanë, sidomos nga radhët e komunitetit serb në Kosovë, që të respektojnë ligjin dhe të mos lejojnë të keqpërdoren për qëllime politike. “U bëjmë thirrje të gjithë bashkatdhetarëve tanë që gjithashtu të mos bien pre e asnjë provokimi nga kushdo qoftë në ditën e nesërme. Tubimet për shënimin e Vidovdanit duhet të organizohen në përputhje të plotë me ligjin, jo të shndërrohen në një mjet për instrumentalizim politik nga autoritetet në Beograd, të cilat tentojnë të eksportojnë krizën e brendshme politike përmes provokimeve në Kosovë, vetëm për t’u paraqitur më pas si kinse ‘mbrojtës të interesave kombëtare’ të tyre dhe të serbëve në Kosovë, përmes narracioneve propagandistike dhe kloro-nacionaliste. Institucionet e Republikës së Kosovës janë të përkushtuara për të garantuar të drejtat dhe liritë e të gjitha komuniteteve, dhe nuk do të tolerojnë veprime që cenojnë rendin, sigurinë dhe paqen publike në Kosovë.

BETOHEN 350 REKRUTË TË RINJ TË FSK-së

“Me mbi 300 milionë euro investime në këto katër vitet e fundit dhe mbi 2700 ushtarë e oficerë të rinj të rekrutuar, ushtria e Kosovës me hapa të shpejtë po ecën drejt zhvillimit me kapacitete të plota si ushtri profesionale me përbërje multietnike”, ka thënë kryeministri në detyrë Albin Kurti

PRISHTINË, 27 QERSHOR - Me një ceremoni ushtarake bënë betimin 350 rekrutëve të rinj të Forcës së Sigurisë së Kosovës, të cilët nga sot do të shërbejnë në radhët e Forcës së Sigurisë së Kosovës, pas trajnimit nëntë javorë në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes. Ceremonia filloi me raportimin para Komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, si akt simbolik i nisjes së një faze të re në jetën ushtarake të të rinjve që kanë zgjedhur t’i shërbejnë atdheut me nder dhe përkushtim. Në praninë e udhëheqësve ushtarakë dhe civilë, përfaqësuesve të institucioneve

të Republikës së Kosovës dhe partnerëve ndërkombëtarë, rekrutët e rinj dhanë betimin solemn për shërbim ndaj vendit, duke shprehur gatishmërinë e tyre për të mbrojtur sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës. Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka uruar diplomimin e 350 ushtarëve të rinj të ushtrisë sonë. “Teksa ata u betuan për të përballur çdo armik e çfarëdo kërcënimi të paqes e të sigurisë, në çdo kohë, ne zotohemi para tyre që do ta kenë gjithnjë përkrahjen e popullit, shtetit dhe qeverisë. Me mbi 300 milionë euro investime në këto katër vitet e fundit dhe mbi 2 700 ushtarë e



oficerë të rinj të rekrutuar - 123% më shumë ushtarë se në vitin 2021 - ushtria jonë po ecën me hapa të shpejtë drejt zhvillimit, me kapacitete të plota si ushtri profesionale, me ushtarakë të përgatitur e të pathyeshëm, për sovranitet shtetërorë të paprekshëm e integriteti territorial të pacenueshëm.

Qofshin me shëndet e me forcë për krejt atdheun tonë në çdo kohë, e gjithmonë faqebardhë!”, ka theksuar Kurti, duke shtuar se përballë armikut e çfarëdo kërcënimi të paqes e të sigurisë, më nuk qëndron Kosova e dikurshme, por ushtria e Kosovës me shumë të rinj e të reja që si ju ballëhapur bartin

uniformën me simbolin e shqiponjës sypatrembur në krah. “Të përgatitur në aspektin profesional e logjistik ushtarët tanë janë të pamposhtur e të pathyeshëm, kurse sovraniteti shtetërorë i paprekshëm e integriteti territorial i pacenueshëm”, ka deklaruar Kurti.

Parandalohet futja e 55,000 eurove të padeklaruara në Kosovë përmes pikës kufitare të Vërmicës

PRISHTINË, 27 QERSHOR - Dogana e Kosovës, në bashkëpunim me Policinë Kufitare, ka parandaluar një tentim për të futur mjete monetare të padeklaruara në territorin e Republikës së Kosovës përmes pikës kufitare të Vërmicës.

Në orët e para të mëngjesit, gjatë një kontrolli të detajuar në hyrje të Kosovës, një automjet u selektua për kontroll të dytë pas deklarimit negativ nga udhëtarët. Gjatë kontrollit u gjetën 55,000 euro në trupin e drejtuesit dhe pasagjerit të

automjetit. Pas konsultimit me prokurorin kujdestar, Dogana ka iniciuar konfiskimin e 25% të shumës së padeklaruar, ndërsa pjesa tjetër e mjeteve është ndaluar përkohësisht deri në përfundim të hetimeve, në përputhje me

Kodin Doganor dhe Akcizës. Dogana rikujton se çdo person që bart mbi 10,000 euro në hyrje ose dalje nga territori i Kosovës është i detyruar ta deklarojë shumën sipas ligjit, dhe mosdeklarimi përbën shkelje që ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi.



QEVERIA NDAN 4 MILIONË EURO PËR POLICAT E SIGURIMIT TË MËRGIMTARËVE DHE MBI 625 MIJË EURO PËR ARSIMIN NË LUGINË

EPOKA E RE Faton DËRAMKU

PRISHTINË, 27 QERSHOR - Qeveria në detyrë e Kosovës në mbledhjen e saj të radhës e mbajtur të premten ka marrë vendim që të ndajë 4 milionë euro për mbulim të kostos së policave të sigurimit për mërgimtarët që vijnë në Kosovë për pushime. Subvencionimi i policave do të nisë nga data 1 korrik. "Me stinën e verës, të gjithë e dimë se vijnë edhe bashkatdhetarët tanë. Mirëseardhja jonë e parë për ta është në pikat kufitare. Edhe sivjet, sikurse viteve të mëparshme, duke filluar nga data 1 korrik, të gjithë bashkatdhetarët që udhetojnë për në Kosovë me automjete për pasagjerë, do të mund të marrin policën e sigurimit falas në cilëndo prej pikave kufitare hyrëse. Polica e subvencionuar do të subvencionohet për automjetet jo-komerciale për pasagjerë, deri në 9 ulëse. Për këtë qëllim, sot do të ndajmë 4,000,000 euro nga masa 'Mbështetje për Mërgatën' e Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Të dashur bashkatdhetarë, mirë se vini e ju faleminderit që na e gjallëroni vendin sa herë që vini", ka theksuar kryeministri në detyrë Albin Kurti. Gjatë mbledhjes, ekzekutivi gjithashtu ka miratuar edhe vendimin për ndarjen e 625 mijë e 400 eurove për mbështetjen e arsimit dhe lobimit institucional për shqiptarët në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. "Në



kuadër memorandumit që kemi me Këshillin Kombëtar Shqiptar, do të ndajmë 626,400 euro si mbështetje për arsimin dhe lobimin institucional për shqiptarët në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, duke përfshirë bursa për studentë, mbështetje për nxënësit dhe financim të aktiviteteve lobuese dhe avokuese në nivel ndërkombëtar. Gjatë qeverisë sonë jemi siguruar që lidhja jonë dhe kujdesi për shqiptarët e Luginës, të jetë institucional dhe financiar. Ky vendim sot, është dëshmia e radhës", është shprehur Kurti.

Ndërkaq Ragmi Mustafi, këshilltar i zëvendës-kryeministrit Besnik Bislimi, ka reaguar për vendimin e Qeverisë së Kosovës për ndarjen e 626,400 euro për Këshillin Kombëtar Shqiptar, në mbështetje të arsimit dhe avokimit institucional për shqiptarët në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. "756 studentë shqiptarë nga 32 vendbanime janë mbështetur me bursa - 407 prej tyre studiojnë në Prishtinë, 110 në Tiranë, e dhjetëra të tjerë në Shkup, Tetovë, Turqi dhe vende të BE-së. Ata ndjekin 56

drejtime studimi në 17 qytete të ndryshme, por bartin të njëjtën aspiratë: dije për të qëndruar, arsim për të mbijetuar, shkollim për të mos u përkulur", ka shkruar ai në "Facebook". Po ashtu, Mustafi ka thënë se 97 fëmijë pa prindër apo me vetëm një prind janë përfshirë në mbështetje direkte, sepse kujdesi institucional fillon aty ku ka më shumë nevojë - te më të pambrojturit. "Mjete për lobim dhe avokim në nivel ndërkombëtar - që zëri i shqiptarëve të Luginës të dëgjohet në tavolina


vendimmarrëse në Evropë dhe më tej. Ky vendim nuk është vetëm një dokument financiar, por një akt politik dhe kombëtar. Është investim në dinjitet, dije dhe barazi. Është angazhim i një shteti që e ndjen përgjegjësinë për bashkë-kombësit përtej kufijve administrativë. Me mirënjohje të thellë për Kryeministrin Albin Kurti, zëvendës-kryeministrin Besnik Bislimi dhe të gjithë kabinetin qeveritar që e shohin Luginën jo si periferi, por si pjesë të pandashme të hartës së përgjegjësisë sonë kombëtare", ka thënë Mustafi.

Rriten të ardhurat nga taksat mjedisore

PRISHTINË, 27 QERSHOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar për herë të parë statistikën e taksave mjedisore, për vitet 2022-2024. Në vitin 2024, të ardhurat nga taksat mjedisore arritën në vlerën 377,704,690 milionë euro, krahasuar me vitin 2023 ka pasur rritje prej 11.0%. Në vitin 2024, të ardhurat nga

taksat e energjisë-akciza, kanë pasur rritje për 9.2%, krahasuar me vitin 2023; të ardhurat nga taksat e ndotjes kanë pasur rritje për 79.3%, krahasuar me vitin 2023; dhe të ardhurat nga transporti kanë pasur rritje për 21.7%, krahasuar me vitin 2023. Sipas strukturës së të ardhurave nga gjithsej taksat mjedisore për vitin 2024,

taksat e energjisë zënë pjesën më të madhe të të ardhurave me 326,128,686 milionë euro, ose 86.3 %, pasuar nga taksat e transportit me 49,245,564, milionë euro, ose 13.0%, taksat e ndotjes me 2,330,440, ose 0.6%. Në vitin 2024, përqindja e të ardhurave nga taksat mjedisore, e pjesëtuar me BPV ishte 4,16%.



MEDIA BRITANIKE: GJYSHI I KREUT TË MI6, NJERI I AFËRT I NAZISTËVE

Gjyshi i Blaise Metreweli, kreut të ri të shërbimit të inteligjencës britanike MI6, ishte Constantine Dobrowolski, spiuni nazist i njohur si "Kasapi", shkruan Daily Mail.

Blaise Metreweli u emërua më parë këtë muaj si shefja e parë femër e spiunazhit në historinë 116-vjeçare të Shërbimit Sekret të Inteligjencës Britanike.

Sipas një arkivi dokumentesh të publikuara nga Daily Mail, gjyshi i saj, Constantine Dobrowolski, ishte një bashkëpunëtor nazist i cili mburrej për vrasjen e hebrenjve. Dobrowolski, i cili ishte ukrainas, dezertoi nga Ushtria e Kuqe për t'u bërë informatori kryesor i Adolf Hitlerit në rajonin e Chernihiv, raportuan mediat britanike.

Metreweli, shkruhet gjithashtu, nuk e takoi kurrë gjyshin e saj. Ai mbeti në Ukrainën e push-tuar nga nazistët kur familja e tij iku nga Ushtria e Kuqe që

çliroi rajonin në vitin 1943. Dokumentet e zbuluara në një arkiv gjerman thuhet se tregojnë se Dobrowolski njihej si "Agjenti Numër 30" midis nazistëve.

Në një moment, Bashkimi Sovjetik ofroi një shpërblim prej 50,000 rublash për Dobrowolskin – tani me vlerë gati gjysmë milioni euro – dhe e quajti atë "armikun më të keq të popullit ukrainas".

Sipas të njëjtit burim, Dobrowolski donte të hakmerrej ndaj Rusisë për vrasjen e familjes së tij dhe konfiskimin e pronës së tyre në revolucionin e vitit 1917. Një dosje dyshohet se përmban një letër të shkruar me dorë nga Dobrowolski drejtuar eprorëve të tij nazistë, të nënshkruar: "Heil Hitler". Në një tjetër, ai mburret se ka marrë pjesë "personalisht" "në shfarosjen e hebrenjve" dhe ka vrarë qindra ushtarë ukrainas.



Një zëdhënës i Zyrës së Jashtme, Komonuelthit dhe Zhvillimit tha: "Blaise Metreweli nuk e njihte ose nuk e kishte takuar gjyshin e saj nga babai. Sfondi i Blaise është i shënuar nga konflikti dhe përçarja dhe, si shumë me trashëgimi të Evropës Lindore, ajo ka vetëm një kuptim të

pjesshëm të tij. Është kjo trashëgimi komplekse që ka kontribuar në angazhimin e saj për parandalimin e konfliktit dhe mbrojtjen e publikut britanik nga kërcënimet moderne nga shtetet armiqësore të sotme, si kreu i ardhshëm i MI6."

Metreweli u rrit jashtë vendit



përpara se të studionte antropologji në Kembrixh. Ajo iu bashkua MI6 në vitin 1999 dhe shërbeu në agjenci në Evropë dhe Lindjen e Mesme për dy dekada. Metreweli aktualisht mban pozicionin e Q, kreut të departamentit teknik të shërbimit, i bërë i famshëm nga filmat e James Bond.


'FATURËN TA PAGUAJNË ARABËT' - SHBA MBAN BISEDIME SEKRETE ME IRANIN

Shtetet e Bashkuara dhe Irani kanë në plan të zhvillojnë negociata sekrete mes tyre për çështjen e pasurimit të urniumit. Burime ekskluzive për median amerikane, CNN, bëjnë me dije se administrata Trump ka diskutuar mundësinë e ndihmës ndaj Iranit prej 30 miliardë dollarë për të pasur akses për të ndërtuar një program bërthamor që prodhon energji për qëllime civile, duke lehtësuar sanksionet dhe duke liruar miliarda dollarë nga fondet e kufizuara iraniane - të gjitha pjesë e një përpjekjeje intensifikuese për ta rikthyer Teheranin në tryezën e negociatave, citon CNN.

Burimet e CNN thanë se aktorë kyç nga SHBA-ja dhe Lindja e Mesme kanë biseduar me iranianët prapa skenave edhe në mes të sulmeve të shumta ushtarake në Iran dhe Izrael gjatë dy javëve të fundit. Këto diskutime kanë vazhduar këtë javë pas arritjes së një marrëveshjeje armëpushimi, thanë burimet.

Zyrtarët e administratës Trump theksuan se janë paraqitur disa propozime. Ato janë paraprake dhe në zhvillim e sipër, me një të panegociueshme të qëndrueshme: pasurim zero iranien të uranimit, për të cilin Irani ka thënë vazhdimisht se i nevojitet. Por të paktën një draft paraprak propozimi, i përshkruar për CNN nga dy burime, përfshin disa stimuj për Iranin.

Disa detaje u sqaruan në një takim sekret, që zgjati disa orë,



midis të dërguarit të posaçëm të SHBA-së, Steve Witkoff, dhe partnerëve të vendeve të Gjirit në Shtëpinë e Bardhë të

premtën e kaluar. Ndër kushtet që po diskutohen, të cilat nuk janë raportuar më parë, është një investim i

vlerësuar prej 20-30 miliardë dollarësh në një program të ri bërthamor iranien pa pasurim, i cili do të përdoret për qëllime

civile të energjisë, thanë për CNN zyrtarë të administratës Trump.

Një zyrtar këmbënguli se paratë nuk do të vinin direkt nga SHBA-të, të cilat preferojnë që partnerët e tyre arabë të paguajnë faturën. Stimuj të tjerë përfshijnë heqjen e mundshme të disa sanksioneve ndaj Iranit dhe lejinin e Teheranit për të hyrë në 6 miliardë dollarët që aktualisht ndodhen në llogari bankare të huaja, të cilat i është ndaluar t'i përdorë lirisht, sipas draftit të përshkruar për CNN.

Një tjetër ide e dalë javën e kaluar që po shqyrtohet aktualisht është që aleatët e mbështetur nga SHBA-të në Gjirin Persik të paguajnë për zëvendësimin e impiantit bërthamor Fordow - të cilin SHBA-të e goditën me bomba bunkerësh gjatë fundjavës - me programin jo-pasurues, thanë dy burime të njohura me çështjen. Por ekspertët iranianë përmendin skenarin e mundshëm që regjimi iranien tani mund të vendosë se i duhet një armë bërthamore.

Më herët gjatë javës, parlamenti iranien miratoi legjislacionin për t'i dhënë fund bashkëpunimit me mbikëqyrësin bërthamor të OKB-së, duke sinjalizuar një dëshirë për të fshehur më tej programin e tyre bërthamor.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Ballkani mposhti në miqësore Rabotniqkin

Skuadra e Ballkanit e ka fituar ndeshjen miqësore ndaj skuadrës maqedonase, Rabotniqki. Tri herë kampioni i Kosovës fitoi të

premtën me rezultat 2-0, ndeshjen e zhvilluar në Ohër. Golat për skuadrën suharekase i shënuan Albert Diene dhe Bleart

Tolaj. “Kjo fitore është dëshmi e punës së palodhshme që po bën ekipi në këtë fazë përgatitore dhe një nxitje e

fortë për ndeshjet e ardhshme që na presin”, ka shkruar në “Facebook” skuadra e drejtuar nga trajneri Orges Shehu.

Ballkani në raundin e dytë kualifikues të Ligës së Konferencës do të luajë me fituesin e duelit Floriana-Haverfordwest.

Llapi fillon përgatitjet me 1 korrik, synon të rikthehet në garë për trofe

“Epoka e re”

PODUJEVË, 27 QERSHOR - Klubi Futbollistik Llapi ka njoftuar se të martën, më 1 korrik do të nis zyrtarisht fazën përgatitore për edicionin e ri garues 2025/26. Grumbullimi i parë i skuadrës do të bëhet në stadiumin “Zahir Pajaziti” duke filluar nga ora 17:00, ndërsa seanca e parë stërvitore do të zhvillohet në ora 18:00. Në njoftimin e klubit që drejtohet nga Tahir Batatina thuhet se synim është që klubi të rikthehet në garë për trofe. Siç dihet Llapi në edicionin e fundit mbajtësen në Superligë e arriti vetëm nëpërmjet ndeshjes se barazhit, kurse në garën e Kupës ishte me suksesshme duke u kualifikuar deri në finale, por aty pësoi humbje nga skuadra e Prishtinës. “Skuadra do të jetë e kompletuar me përforsimet e reja si dhe me futbollistët që kanë mbetur nga edicioni i kaluar, me



synim të qartë – të rikthehemi në garë për trofe dhe plasman në garat evropiane. Gjatë kësaj faze përgatitore janë planifikuar disa ndeshje miqësore, si dhe një fazë përgatitore jashtë vendit, për të cilat do të jeni të informuar në vijim përmes mjeteve tona të informimit”,

thuhet në njoftimin e kësaj skuadre. Llapi ka bërë me dije se gjatë fazës përgatitore, do të mbajë opinionin e njoftuar në vazhdimësi për të gjitha zhvillimet nga kampi bardhekaltër – përfshirë afrimet, largimet dhe çdo risi që lidhet me ndërtimin e skuadrës për sezonin e ri futbollistik.

Nga Xhaka te Jashari, ja dëshirat e Tares te Milani

Milano, 27 qershor - Te Milani nuk do të ketë një revolucion të mirëfilltë këtë verë, por ndryshimet pritet të jenë të thella. Drejtori sportiv Igli Tare ka qenë i qartë në deklaratat e tij. “Prioriteti është një regji e re. Po shikojmë Modriçin, Loftus-Cheek dhe një sulmues përkrah Gimenezit. Kështu ndërtojmë edhe Milan të ri”. Në të njëjtën linjë edhe administratori Furlani: “Nuk kemi nevojë për një revolucion, por do ketë ndryshime domethënëse”. Synimi është të afrohen të paktën gjashtë lojtarë për të mbuluar hapësirat e dobëta në



krahët e mbrojtjes, mesfushë dhe qendërmbrojtje. Ja cilët janë emrat që priten në “San Siro”. Lideri i mesfushës së Bayer Leverkusenit dhe

kapiteni i Zvicrës, është një profil që Milani e sheh si “regjisorin” ideal. Me 137 ndeshje me përfaqësuesen dhe eksperiencë të gjatë në Premier League, Xhaka ka shanse reale të transferohet për rreth 15 milionë euro. Shanset aktuale, 70%. Një tjetër zvicëran në fokus, i shpallur lojtar i mirë në kampionatin belg, Ardon Jashari, Milan ka ofruar 27 milionë plus 5 bonuse, por Brugge po kërkon të paktën 35 milionë. Borussia Dortmund është tërhequr, çka i jep Milanit më shumë hapësirë. Shanset për marrëveshje, 50%.

SHKURT

Shipkovica, i pesti në Evropian

Mundësi i ri, Harun Shipkovica, ka vazhduar me paraqitje të suksesshme edhe në Kampionatin Evropian U-15, që po mbahet në Caorle të Italisë. Shipkovica zuri vendin e pestë në kategorinë -48 kg. Ai shënoi tri fitore, ndërsa në luftën për medalje të bronzte pësoi humbje. Vendi i pestë në Evropian është sukses për Harunin, i cili dëshmoi se ka të ardhme të ndritur në mundjen tonë.

Vedat Muriqi e viziton klubin e tij të parë, FC Liria

Vedat Muriqi të premtën ka vizituar klubin e tij të parë, dhe të vendlindjes FC Liria nga Prizreni, derisa sulmuesi i Kosovës po qëndron për pushime. Sulmuesi i skuadrës së njohur spanjolle të Mallorca u prit nga drejtori sportiv i klubit prizrenas, Valon Bytyqi. Muriqi i cili nisi karrierën si i ri te klubi nga Prizreni, kaloi më pas në kampionatin turk, prej nga u transferua në Spanjë, duke u bërë njëri nga golashënuesit më të mirë në La Liga.

Edhe Torino në garë për Ismajlin

Pas Bolognas dhe Veronës, në garë për shërbimet e Ardian Ismajlit ka hyrë edhe skuadra e Torinos. Kështu ka raportuar të premtën mediumi “Tuttosport”. Ismajli vlerësohet si përforsim i duhur për ekipin e drejtuar nga trajneri Marco Baroni. Një tjetër arsye për interesimin e reprezentuesit të Shqipërisë, është se Ismajli mund të transferohet si futbollist i lirë pasi i skadon kontrata në verë. 28-vjeçari Ismajli luajti në 31 ndeshje me Empolin në edicionin e kaluar, por, skuadra e tij nuk arriti që ta sigurojë mbijetesën në Serie A. Empoli e mbylli sezonin në vendin e 18-të me 31 pikë.

Flamurtari emëron trajner spanjollin Carlos Garcia

Carlos Garcia Badias është zyrtarisht trajneri i ri i Flamurtari Football Club. Ekipi i vlonjatëve i është besuar, 41-vjeçarit spanjoll. Flamurtari do të bëhet

kështu ekipi i tij i dytë që ai do të drejtojë nga stoli. “Mire se vjen ne familjen e madhe Kuqezi te Flamurtari F.C”, ka shkruar në rrjetet sociale, ekipi vlonjat.

Trajneri spanjoll e ka nisur karrierën te Dangdai në Kinë si ndihmës. Në vitin 2022 mori drejtimin e TLV Bat Yam, ekipi i vetëm ku ka qenë trajner i parë. Më pas

ishte Serie A, ekipi ku Carlos Garcia Badias vazhdoi rrugëtimin si asistent teknik te Udinese dhe më pas në ShBA si ndihmëstrajner te Chicago.

Carlos Garcia Badias ka lindur në Barcelonë dhe ka luajtur me Espanyol, Almeria, Real Betis, Macabi Tel Aviv apo edhe Alanyaspor.

FShF-ja 'hap thesin', 3 milionë euro për Superiore dhe Kategorinë e Parë

TIRANË, 27 QERSHOR - Federata e Futbollit të Shqiperise (FShF) ka ndërmarrë një hap të rëndësishëm për zhvillimin e futbollit profesionist, duke vendosur për një rritje të konsiderueshme të mbështetjes financiare për

klubet e "Abissnet Superiore" dhe Kategorisë së Parë. Gjatë punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të Zakonshme, Presidenti i FSHF-së, Armand Duka, njoftoi këtë vendim, duke e konsideruar si një hap të rëndësishëm, me të

ardhurat që do të vijnë nga komercializimi. "Do të rrisim me 30% të ardhurat nga komercializimi dhe, në vitin 2026, do të shpërndajmë 3 milionë euro për klubet e Kategorisë Superiore dhe të Parë, si mbështetje direkte

financiare për përmirësimin e funksionimit të tyre", u shpreh Duka. Mbështetja financiare do të shpërndahet gjatë periudhës ndërmjet dy asambleve dhe përbën një hap të rëndësishëm për rritjen e standardeve në menaxhimin e



klubeve, rritjen e cilësisë së garës dhe krijimin e kushteve më të mira për lojtarët, trajnerët dhe stafet teknike.

Ancelotti: Neymari është i rëndësishëm për Brazilin në Kupën e Botës 2026

SAO PAULO, 27 QERSHOR - Pavarësisht problemeve të vazhdueshme fizike, Neymar mbetet në zemër të projektit teknik të trajnerit të ri të Brazilit, Carlo Ancelotti, në prag të Kupës së Botës 2026. Në një intervistë me CONMEBOL, trajneri italian i kërkoi numrit 10 të "Seleção"-s të marrë kohën e nevojshme për t'u rikuperuar dhe për t'u rikthyer në formë. "Ai duhet të përgatitet mirë dhe ka kohën për ta bërë këtë. Ai është një lojtar shumë i rëndësishëm për ne në prag të Kupës së Botës", ka thënë Ancelotti. Neymar, 33-vjeçar, së fundmi rinovoi kontratën e tij me Santos deri në fund të vitit, klubin ku ai shpërtheu dhe ku u rikthye janarin e kaluar. Megjithatë, kjo periudhë e re braziliane është shënuar edhe nga lëndimet: vetëm 12 paraqitje në pesë muaj, me një total prej



3 golash dhe 3 asistesh në kampionatin shtetëror të Sao Paulo. Në Serie A braziliane, ai ka luajtur vetëm 4 nga 11 ndeshjet e luajtura nga Santos, aktualisht i pesëmbëdhjeti në renditje, në mes të një beteje për rënie nga kategoria. I thirrur në mars për kualifikueset e Kupës së Botës, Neymar u detyrua të tërhiqej për shkak të një tjetër dëmtimi muskulator. Gjithashtu mungoi

në listën e parë të hartuar nga Ancelotti në maj, kampioni brazilian, golashënuesi më i mirë në historinë e "Seleção" me 79 gola, dy më shumë se Pele dhe tani synon të rikuperohet për t'u rikthyer në plan të parë në vitin 2026. Ndërkohë, Brazili është kualifikuar për Kupën e Botës pa të, falë barazimit në Ekuador (0-0) dhe fitores kundër Paraguait (1-0).

SHKURT

Guardiola pas fitores ndaj Juves: Kishim kohë që nuk luanim një ndeshje të tillë

Trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola, foli për "Mediaset" pas fitores 5-2 ndaj Juventusit në Botërorin e Klubeve. "Pa dyshim që jam i kënaqur. Mundëm një ekip që kishte luajtur dy ndeshje të jashtëzakonshme. Juventus është gjithmonë Juventus. Për ne ka kaluar shumë kohë që kur kemi luajtur kështu. Ne vazhdojmë të mendojmë se vitin e kaluar kishim një ekip të mirë, por pësuam shumë lëndime. Por tani e kemi gjetur veten përsëri. Kjo është rruga që duhet të ndjekim, nuk duhet të flasim, por të punojmë shumë", ka thënë Guardiola. "Ne fituam dy ndeshjet e mëparshme, por nuk patëm të njëjtat situata. Duhet ta gjejmë përsëri identitetin tonë, pastaj të fitojmë ose jo, kujt i intereson. Gjëja e rëndësishme është ta gjejmë veten përsëri", ka shtuar trajneri spanjoll. Më tej, duke folur për Haalandin, trajneri Guardiola a shtuar: "Ky djalë shënon gola. Pastaj ai duhet ta dijë se ka konkurrencë. Marmoush luajti mirë, të gjithë duhet të japin gjithçka. Përndryshe do të jetë e vështirë për të gjithë".

Tudor: Humbje e shëmtuar

Juventus ka pësuar humbje me rezultat të thellë nga Manchester City (5-2), në Botërorin e Klubeve. Trajneri i "Zonjës së Vjetër", Igor Tudor ka thënë se City ka cilësi dhe se rezultati i kësaj ndeshje ishte i shëmtuar. "I bej komplimente Manchester Cityt. Është një rezultat i shëmtuar, nuk më pëlqen. Ata janë një ekip me shumë cilësi, por ne nuk arrinim dot të rrëmbenim topin, për të dalë përpara. Nuk kam çfarë t'i them djemve, madje as nuk do ta rishikojmë si ndeshje. Kjo humbje duhet harruar sa më shpejt pasi turneu është i gjatë", ka thënë Tudor.

De Jong pranon uljen e pagës

Frenkie De Jong ka rënë dakord të ulë pagën e tij për të zgjatur kontratën e tij me Barcelonën këtë verë, sipas "Diario AS". Klubi katalunas ishte në konflikt me De Jong vetëm një vit më parë për të njëjtën kontratë dhe madje u përpoq ta shiste atë. Lojtari qëndroi në klub vetëm me vullnet, u rikthye në formë dhe ndryshoi rëfimin për veten me performancat e tij në fushë. Me kontratën e tij aktuale që skadon më 30 qershor 2026, De Jong tani ka rënë dakord të ulë pagën e tij të lartë dhe të nënshkruajë një kontratë të re, megjithëse ende duhet t'i paguajë pagën e shtyrë. Me uljen e pagave të De Jong, Barça do të lirojë shumë hapësirë për pagat që do t'i ndihmojë ata të regjistrojnë Nico Williams. Largimi i Ansu Fati për në Monaco gjithashtu do të ndihmojë.

Van Nistelrooy largohet nga Leicester City

Klubi i Leicester City ka konfirmuar zyrtarisht ndarjen me trajnerin Ruud van Nistelrooy, pas një marrëveshjeje të arritur me mirëkuptim mes palëve. Lajmi vjen pas javësh spekulimesh, që pas rënies së klubit nga Premier Ligë në fund të sezonit të kaluar. "Leicester City Football Club dhe Ruud van Nistelrooy kanë rënë dakord me mirëkuptim që kontrata e Ruud-it si trajner i ekipit të parë të përfundojë menjëherë. Ruud ka udhëhequr klubin në një periudhë sfiduese. Që nga emërimi i tij në nëntor 2024, ai ka treguar profesionalizëm, integritet dhe përkushtim të qartë ndaj objektivave tona, përfshirë integritetin e disa lojtarëve premtues nga akademia në ambientin e ekipit të parë. Ai largohet me respektin dhe falënderimet e të gjithëve në klub për përkushtimin dhe punën e tij, dhe me urimet tona më të mira për të ardhmen", thuhet në njoftimin e Leicesterit.

Piastri: Do të vazhdoj të luftoj me Norris për titullin

WOKING, 27 QERSHOR - Piloti australian i McLaren, Oscar Piastri, konfirmoi se klima brenda makinës britanike nuk ka ndryshuar aspak pas incidentit që ai pati me Lando Norris në garën e fundit të Formula 1, zhvilluar në Kanada dy javë më parë. "Lando kërkoi falje menjëherë pas garës, kështu që gjithçka është në rregull. Mezi presim të kthehemi në pistë këtë fundjavë. Rregullat brenda ekipit nuk ndryshojnë", ka thënë kryesuesi i Botërorit. Më tej, Piastri ka vazhduar: "Ajo që ndodhi në Kanada nuk ishte ideale, por do të vazhdojmë të luftojmë mes vete, duke shpresuar të mos biem përsëri në kontakt". Në Montreal, McLaren pati më shumë vështirësi se sa në



garat e tjera. "U kapëm në befasi në Kanada, nuk ishim aq të fortë sa pritej. Në kualifikime patëm vështirësi, ndërsa në garë kishim shpejtësi, por paguam për të filluar nga fundi. Mendojmë se e kemi kuptuar se çfarë shkoi keq", ka thënë Piastri. Ekipi i Woking,

ashtu si makinat e tjera, po sjell përmirësime për garën austriake. "Po sjellim pjesë të reja, veçanërisht diçka në pjesën e përparme. Shpresojmë se mund të na bëjë të shkojmë më shpejt, ky është zakonisht plani", ka deklaruar Piastri.

Lille po synon rikthimin e Giroudit në Ligue 1

Olivier Giroud është i gatshëm të rikthehet në Ligue 1, me Lille që po punon intensivisht për të siguruar shërbimet e tij gjatë kësaj vere. Sipas portalit të njohur "Foot Mercato", klubi verior francez ka

shfaqur interes serioz për sulmuesin 37-vjeçar, i cili aktualisht është pjesë e Los Angeles FC në MLS. Burime të afërta me negociatat konfirmojnë se bisedimet mes palëve po ecin në

drejtimin e duhur. Giroud ka një kontratë me ekipin amerikan që zgjat deri në dhjetor 2025, me opsion rinovimi për një vit tjetër në dorën e klubit. Megjithatë, pas eliminimit të LAFC nga Botërori për

Klube, pritet një takim vendimtar për të përcaktuar të ardhmen e francezit. Lille është duke përgatitur një ofertë me kontratë njëvjeçare dhe opsion rinovimi edhe për një sezon tjetër. Optimizmi është i lartë

në kampin e klubit francez, sidomos për faktin që vetë Giroud dëshiron të rikthehet në elitën e futbollit francez, ku nuk ka luajtur që nga sezoni 2011 kur u largua nga Montpellier.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qera te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokolli 119 date 11.01.2021, Zyra e shitjes me datën 27.06.2025 bënë shpallje publike për dhënin e pronës së paluajtshme me qera.

Shpallje Publike

T-25-7

Autoriteti Kontraktues (AK): Trepça Sh.A.

Adresa e AK: Parku Industrial
MITROVICË
40000

Personi Kontaktues: Arjanit Ademi
E-mail: arjanit.ademi@trepcasha.com
Telefoni: +381 28 538 050
Faks: +381 28 539 202

Shpallja Publike

Qëllimi i ofertës:

- Dhënie me qera e hapësirave
- Sipërfaqja dhe çmimi fillestar

Llogaritja e çmimit fillestar:

Loti 1						
Nr		Sipërfaqja (m ²)	Çmimi neto (€)	Çmimi pa TVSH (€)	TVSH 18 %	Tatimi 9 %
1	Depoja gjindet në parcelën P-7120812801090-0	600.00	0.80	480	86.400	43.20
	Pjeserisht Depoja Reparti I gomes ne industrine e baterive.					
						523.20

Loti 2						
Nr		Sipërfaqja (m ²)	Çmimi neto (€)	Çmimi pa TVSH	TVSH 18 %	Tatimi 9 %
1	Depoja gjindet në parcelën P-7341400400012-0	192.00	1.00	192	34.560	17.28
	Depoja në Hajvali - Zhveshitorja e Minatorëve të Hajvalisë.					
						209.28

Kriteret e Dhënies: Dhënia e kontratës do të bazohet në çmimin më të lartë

Data e shpalljes: 27.06.2025

Sqarimi: deri me 14.07.2025

Kërkesa për pjesëmarrje: Data(t) për kërkesës deri: 14.07.2025

Bëhet në e-Mail: poshtë shënuar ose në Zyrën e shitjes dhe qirasë.

Dorëzimi i ofertave: Dorëzimi i ofertave bëhet ne formë fizike (zarf te mbyllur) (Originali dhe Kopja)

Afati i fundit i dorëzimit: 14.07.2025 në 11:00

Vendi i dorëzimit: Zyra e shitjes dhe qirasë të Trepça Sh.A.
Parku Industrial, Mitrovicë (PIM)

Kërkesat minimale të kualifikimit:

1. Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit të entitetit.
2. Kopje të certifikatës së regjistrimit për TVSH (vetëm për ofertuesit vendor)
3. Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore se operatori ekonomik në fjalë nuk është në vonës në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të njoftimit për kontratë.
4. Nuk ka obligime ndaj Trepçës të pa paguara.

Shënime shtesë:

Çmimi i ofertës: Çmimi i ofruar nga O.E të interesuar do të jetë më i madh apo i barabartë me çmimin e parashikuar nga Autoriteti Kontraktues - Trepça Sh.A.

Obligimet: Ofertuesi fitues do të bartë të gjitha obligimet e investimeve si dhe te gjitha shpenzimet administrative, komunale dhe shpenzimet tjera të cilat dalin mbas lidhjes së kontratës.

Oferta: Duhet të përfshijë çmimin për m² duke përfshirë TVSH-në dhe Çmimin total shih Aneks1.

Pagesa: Të gjitha pagesat do të bëhen në EURO, pa ndalesë, kundërkërkesë ose çfarëdo zbritje në llogarinë bankare të Trepça Sh.A.

Operatorët ekonomik: që nuk i paraqesin të gjitha të dhënat për formimin e çmimit Aneks 1 dhe deklarimi Aneksi 2 Ofertat e tyre nuk do të shqyrtohet.

Aneksi 1 OFERTA

Emri i OE:	
Loti	
Kodi (T)	

D=a*c	Vlera e qerasë për sipërfaqen e mbuluar (€)	
a	Sipërfaqe m ²	
b	Çmimi për m ²	
c = a*b	Vlera pa TVSH	
d = c * 18 %	TVSH 18 %	
e = c + d	Total	
f = c * 9 %	Tatimi - 9 %	
g = e - f	Për pagesë	

Tatimi në qira prej 9% gjithashtu bije në barrë të qiramarrësit dhe pagesën e saj e bënë qiramarrësi

Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: *operatorin ekonomik që paraqitet* deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Rregulloren për dhëne me qira te pronës se paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokolli 119 date 11.01.2021.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në rregulloren dhe siguroj se jam i përshtatshëm të marrë pjesë.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	
Adresa e plotë:	
I përfaqësuar nga:	
Emri:	
Pozita:	
E-mail:	
Tel:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

Aneks 3. Pjesëmarrja

Pjesëmarrja - Marrja e Aplikacionit mund të behet deri me datën **14.07.2025** përmes e-mail ose në Zyren e Shitjes.

Aneks 4. Përshkrimi i Aseteve

Përshkrimi i asetëve të shënuara më poshtë shërbejnë vetëm për qëllime të informimit dhe Autoriteti Kontraktues nuk ofron garanci të saktësisë së përshkrimit. Këto asete jepen në kushte të gjendjes aktuale “ashtu siç janë dhe ku janë” dhe autoriteti kontraktues nuk ofron Garancion në lidhje me gjendjen e asetëve. Tenderuesi bartë rrezikshmërinë e plotë për gjendjen e asetëve.

Objekti është i ndarë në lote,

Trepça Sh.A. përmes këtij njoftimi përcakton kushtet dhe termet dhënës me qiratë objekteve dhe hapësirave sipas tenderit me metodën e çmimit ekonomikisht më të lartë, bazuar në parametrat e poshtëshënuar që përcaktojnë formimin e çmimit ekonomikisht më të lartë.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

